



Pranuar / Dorezuar Prilbena / Predato Received / Delivery	12.05.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHIJK	2372/2021		1/0



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.328/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2739/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.532/2019 të datës 10.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati "Negofc" në Komunën e Drenasit, kundër Vendimit me Nr.Prot: 177 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.532/2019 e datës 10.09.2019 e parashtruar nga ankuesi e shqyrtuar sipas Aktgjykimit A.nr.2739/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. Prot:177 i datës 15.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 17.05.2019 ka parashtruar kërkesën për fillim të rekrutimit tek Ministria e Administratës Publike, ndërsa Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, më datë 24.05.2019 ka aprovuar kërkesën e Administratës Tatimore të Kosovës.

Administrata Tatimore e Kosovës duke u bazuar në autorizimin e lartcekur, më datës 28.05.2019 ka shpall konkursin e brendshëm për (avancim) për pozitën "Udhëheqës i Ekipit në ATK-8

pozita" në kuadër të Drejtorive Rajonale, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe kandidati cili ka marr pjesë na fazat e procedurës së rekrutimit. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit Administrata Tatimore e Kosovës më datë 28.06.2019 ka bërë publikimin e njoftimit për kandidatët e suksesshëm në bazë të të cilës ankuesi nuk është kandidat i rekomanduar për pozitën e lartcekur.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 28.06.2019 për kandidatët e suksesshëm më datë 24.07.2019, ka parashtruar ankesën me Nr. Prot:11-06-3078 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, tek Administrata Tatimore e Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 15.08.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:177 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi njoftimin e datës 28.06.2019.

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin me Nr. Prot:177 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4262/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.09.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa më datë në 15.10.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020 ka qenë jofunksional, më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit ndërsa më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale, me që rast është funksionalizuar këshilli dhe për këtë arsye nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit. Më datë 24.10.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 16.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2739/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 24.10.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e datës 10.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4262/2019 të datës 10.09.2019 e parashtruar nga ankuesi

në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 24.07.2019 me Nr. Prot: 11-06-3078 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; ; Emali i datës 04.09.2019, 01.07.2019, 28.06.2019 nga Vendimin me Nr. Prot:177 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Njoftimi i datës 28.06.2019 për kandidatët e suksesshëm; Njoftimin me Nr. Prot: 322 i datës 11.06.2019 për kandidatët për testimin nga përzgjedhja e ngushtë i dorëzuar nga ankuesi; Konkursi i brendshëm i datës 28.05.2019 për pozitën "Udhëheqës i Ekipi në ATK-8 pozita" i shpallur nga ATK; Kërkesën për fillimin e procesit të rekrutimit i datës 17.05.2019; Autorizimi i datës 24.05.2019 i lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike; Vendimin me Nr.Prot: 277 i datës 05.06.2019 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Deklaratën lidhur me emërimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil e datës 05.06.2019; Formularin për regjistrin e kërkesave të pranuar; Form.MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë; Lista e vlerësimeve të listës së ngushtë; Njoftimin me Nr. Prot: 322 i datës 11.06.2019 për kandidatët për testimin nga përzgjedhja e ngushtë i dorëzuar nga ATK; ; Formulari Form.MAP-SHCK-05/b për ranglistën përfundimtare sipas rezultateve të testit me shkrim e datës 14.06.2019; Njoftimin e datës 18.06.2019 për mbajtjen e intervistës me gojë; Formularin Form.MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin Form.MAP-SHCK-10 për renditja përfundimtare të kandidateve; Formularin Form.MAP-SHCK-11 për raportin final me rekomandim nga Komisioni Rekrutues; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 31.05.2019 së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e datës 31.05.2019 të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e datës 03.06.2019 të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e datës 31.05.2019 të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e datës 30.05.2019 të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e datës 03.06.2019 të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e datës 29.05.2019 të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e datës 03.06.2019 të kandidatit së bashku më dëshmitë e bashkangjitura; Testi me shkrim i datës 13.06.2019 i kandidatit

dhe ankuesit E-mailin e datës 24.10.2019 nga E-mailin e datës 21.10.2019 nga dhe Përgjigjen në ankesë e datës 15.10.2019; E-mailin e datës 28.05.2019 nga për Stafin e ATK; Aktgjykimin A.nr.2739/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 24.10.2019 për ankuesin; Kërkesën për informata të datës 22.02.2021 për ankuesin dhe njoftimin e datës 22.02.2021 të ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar qe ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se: Administrata Tatimore e Kosovës konkursin për pozitën "Udhëheqës i Ekipit ATK-8 pozita) nuk e ka shpall në EEB faqen e institucionit; Testi me shkrim ka pasur dy pyetje të njëjta; nuk ka pasur zgjatje të afatit në këtë konkurs; Kandidati ka kaluar testin me shkrim dhe është ftuar në testin me gojë pa aplikuar fare në këtë pozitë; Në konkursin e mëhershëm për këtë pozitë kam qenë i përzgjedhur mirëpo meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk ka miratuar këtë pozitë atëherë ATK e ka dërguar në gjykatën kompetente; nuk jemi njoftuar me shkrim për rezultatin përfundimtar; është shkelur Rregullorja MF.Nr.01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Rekrutimit, Zhvillimit, Transferimit dhe Shkarkimit të Stafit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Administrata Tatimore e Kosovës konkursin për pozitën "Udhëheqës i Ekipit ATK-8 pozita" nuk e ka shpall në EEB faqen e institucionit, ka konstatuar që në bazë të provave të lëndës Menaxherja e Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës znj. më datë 28.05.2019 ka njoftuar e e-mail të gjithë stafin e Administratës Tatimore të Kosovës se është shpallur konkursi për Udhëheqës të Ekipit në ATK 8 pozita dhe i njëjti është i hapur nga data 28.05.2019 deri më datë 04.06.2019 duke i ftuar të gjithë të interesuarit që plotësojnë kushtet të aplikojnë, kështu që bazuar në këtë meqenëse konkursi për pozitën "Udhëheqës i Ekipit ATK-8 pozita) ka qenë i brendshëm atëherë në kuptim të kësaj rrethane neni 5 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil përcakton se: *"Shpallja për avancim bëhet nga njësia e personelit brenda institucionit përkatës në vendet e përshtatshme ku kanë qasje të gjithë nëpunësit civilë"*, bazuar në këtë meqenëse i gjithë stafi i Administratës Tatimore të Kosovës ka qenë i njoftuar me e-mail që është hapur konkursi i brendshëm, vlerësojmë që nuk ka shkelje procedurale në këtë aspekt dhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se testi me shkrim ka pasur dy pyetje të njëjta, ka konstatuar se testi me shkrim për pozitën "Udhëheqës i Ekipit ATK-8 pozita" është mbajtur më datë 13.06.2019 dhe testi ka qenë i përbërë nga tri (3) pjesë, dhe janë paraparë numër i mjaftueshëm i pyetjeve siç parashihet me nenin 36 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, rrjedhimisht të gjitha pyetjeje për të gjithë kandidatët kanë qenë të njëjta dhe vlerësimi është bërë për të gjithë njëjtë në pajtim me nenin 37 të kësaj rregulloreje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se nuk ka pasur zgjatje të afatit në këtë konkurs, ka konstatuar se meqenëse kanë qenë të njoftuar i gjithë stafi i Administratës Tatimore të Kosovës për shpalljen e këtij konkursi atëherë nuk ka pasur asnjë arsye të bëhet vazhdimi i këtij konkursi, sepse të gjithëve i'u është dhënë e drejta e barabartë për të aplikuar në këtë konkurs, në këtë rast janë përfillur të gjitha procedurat ligjore në fuqi, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se kandidati ka kaluar testin me shkrim dhe është ftuar në testin

me gojë pa aplikuar fare në këtë pozitë, ka konstatuar që në bazë të regjistrit të aplikacioneve të pranuar ky kandidatët nuk ka aplikuar në pozitën Udhëheqës i Ekipit në ATK në 8 pozita, mirëpo në ditën e mërkurë të muajit qershor të vitit 2019 Menaxherja e Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës ka njoftuar z. *se "gjatë njoftimit për test me shkrim tek pozita Udhëheqës Ekipi Drejtorit Rajonale është lëshuar gabim teknik. Ju keni aplikuar për pozitën Udhëheqës Ekipi DTM dhe duhet të jeni në listën e DTM-së. Ju njoftoj se testi me shkrim për pozitën Udhëheqës Ekipi ATK-DTM do të mbahet ditën e enjte datë 13.06.2019 me fillim nga ora 10:00h. Testi mbahet në Sallën e DTM-së"*, bazuar në këtë por edhe në të gjitha provat e lëndës, ky kandidat ka aplikuar vetëm në pozitën Udhëheqës Ekipi në DTM dhe nuk ju ka nënshtruar testit për pozitën Udhëheqës i Ekipit në ATK në 8 pozita sepse nuk ka asnjë dëshmi për këtë, për më tepër tek lista përfundimtare e rezultateve të testit me shkrim nuk figuron emri i z. *kështu që në bazë të provave të lëndës është bërë vetëm gabim teknik ndërsa, nga Menaxherja e Personelit e Administratës Tatimore të Kosovës është përmirësuar gabimi, dhe ky kandidat i është nënshtruar testit me shkrim vetëm për pozitën Udhëheqës Ekipi në DTM, këtë e dëshmon edhe ranglista përfundimtare sipas rezultateve të testit me shkrim, kështu që pretendimi i ankuesit është i paqëndrueshëm.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se në konkursin e mëhershëm për këtë pozitë kam qenë i përzgjedhur mirëpo meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk ka miratuar këtë pozitë atëherë ATK e ka dërguar në gjykatën kompetente, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin Nr.178/2018 të datës 10.08.2018 ka anuluar konkursin për pozitën Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit për 10 pozita për shkak të shkeljeve procedurale, ndërsa vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është zbatuar nga Administrata Tatimore e Kosovës në bazë të Vendimit me Nr. Prot:846 të datës 06.9.2018, bazuar në këtë, në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se nuk jemi njoftuar me shkrim për rezultatin përfundimtar, ka konstatuar që lidhur me rezultatin përfundimtar palët që kanë marr pjesë në procedurën e rekrutimit janë njoftuar sipas procedurave të nenit 41 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se është shkelur Rregullorja MF.Nr.01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Rekrutimit, Zhvillimit, Transferimit dhe Shkarkimit të Stafit, ka konstatuar se bazë për emërim në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, ka qenë Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil dhe aktet nënligjore të tjera që derivojnë nga ky ligj, ndërsa Rregullorja MF.Nr.01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Rekrutimit, Zhvillimit, Transferimit dhe Shkarkimit të Stafit nuk është e zbatueshme në këtë aspekt, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me të gjitha ato që u thanë më lartë, ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Ekipit në ATK në 8 pozita, është zhvilluar në pajtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"*, dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, me nxjerrjen e Vendimit me Nr.Prot: 177 të datës 15.08.2019, ka vendosur në pajtim me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që ka shqyrtuar në tersi pretendimet ankimore të ankuesit në ankesë, duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë ka vepruar edhe në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.


Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.328/2021, datë 12/05/2021

Avdy BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të përgjithshëm të administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.